

Nr. regj. 14830/12

REPUBLIKA E KOSOVES		REPUBLIC OF KOSOVO	
			
Libri	DPK/DMP	Nr. regj.	03-3562/12
Drejtori		Nr. akti	
Dati	02	Data	05.10.2012
Në emër të...			

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, Gjyqtarja Lindita Jakupi me pjesëmarrjen e sekretares juridike Iqrame Aliu, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër Flamur Doli nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 16 par.1.1 te Ligjit për Deklarimin e Prejardhjes dhe Kontrollin e Pasurisë dhe te Dhuratave të Zyrtareve të Lartë Publik nr. 03/L-151, e në bazë të nenit 73.73.195, 199 te Ligjit mbi Kundërvajtjet, me dt. 24 .09. 2012, merre këtë:

AKTVENDIM

I PANDEHURI: Flamur Tahir Doli, i lindur më 16.05.1951 në Gjakovë, tani jeton në Prishtinë në Rr. Leke Dukagjini 6/2 L D 9/48, i martuar baba i dy fëmijëve, Arkitekt-Prodekan për Mësim FNA, me shkollim superior, i gjendjes së mesme ekonomike, deri tani thotë jo i dënuar.

Ë shtë pë r g j e g j ë s

Sepse me si Zyrtar i lartë Publik, në Pozitë Prodekan për Mësim FNA, nuk e ka bërë deklarinë e rregullt të gjendjes së pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsionit, brenda afatit ligjor me 31.03.2012,

- **me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2 të ndëshkuar me nenin 17 paragraf. 1.1 te Ligjit për Deklarimin , Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe te Zyrtareve të Lartë Publike**, andaj te pandehurit për këtë kundërvajtje i shqiptohet,

DENIMI

Me gjobë në shumë prej **2000 (dymijë)** Euro. Gjjobën e shqiptuar i pandehuri është i obliguar ta paguaj brenda 15 ditësh pasi që aktvendimi të merr formën e prerë në favor të hyrave gjyqësore të KGJK-ës në llogarinë rrjedhëse nr.1000-4300-7000-0518. Pagesa bëhet në ndonjërin e të hyrave –bankë, përmes urdhërpagesës të plotësuar nga Gjykata.

Po që se brenda afatit të caktuar i pandehuri nuk e paguan gjjobën e njejtë do të zëvendësohet me denim burgimi në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë ditësh), duke llogaritur 15 (pesëmbëdhjetë) euro në një ditë burgimi.

Në emër të paushallit i pandehuri është i obliguar të paguaj shumën prej **5 (pesë)** Euro në afat të njejtë sikurse gjjobën në të njëjtën llogari rrjedhëse. Shpenzime të procedurës nuk ka patur.

Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dërgohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

Arsyetim

Agjencinë Kundër Korrupsionit në Prishtinë, parashtroi kërkesën nr. 01 1613/2012 të dt. 30.04.2012, për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj te pandehurit të shënuar për kundërvajtjen e precizuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Në bazë të kërkesës së ushtruar, Gjyqtarja filloi procedurën kundërvajtëse me marrjen në pyetje te pandehurit i cili në mbrojtjen e vet deklaroi se si Prodekan për Mësim FNA, nuk kishte qenë i informuar as nga Agjencinë Kundër Korrupsionit e as nga Dekani i Fakultetit, për arsye se dy vitet e kaluar ishte informuar nga Dekani përmes interneti dhe gojarisht, por këtë vit nuk ishte informuar nga askush, me tej shton se është i angazhuar me shume punime shkencore dhe nuk i kishte renë në mend për një obligim të tillë. Për vërtetimin e gjendjes faktike gjyqtari morri në pyetje dëshmitarin –Fidan Hamiti, menaxher i personelit në Universitetin e Prishtinës, cili ka deklaruar: se kishte qenë pika kontaktuese në mes të mes të Universitetit të Prishtinës dhe Agresionit Kundër korrupsionit. Në vazhdim thekson se aplikacionin e te pandehurit ja kishte dërguar Valdete Shalës, Sekretare në fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës. Gjithashtu Gjyqtarja mori në Pyetje Valdete Shalën, Sekretare në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, e cila deklaroi se personalisht e kishte njoftuar gojarisht te pandehurin se ka arritur aplikacionin nga Agjencinë Kundër Korrupsionit për deklarinë e pasurisë, si dhe për këtë e kishte njoftuar edhe Dekanin e fakultetit Naser Kabashi i cili po ashtu i kishte rikujtuar te pandehurin për përmbushje të obligimit.

Nga te dhënat ne kërkesë, vlerësimin i deklaratës se te pandehurit, dëgjimit te dy deshmitareve, ushtruesit te Krkeses Enis Sadiku, Zyrtat ne Agjencionin Kunder Korrupsionit, Deklarates se Dekanit te FNA, dhe baze të dhënave te parashtruara në kërkesë, shiqimit të shkresave të lendes dhe provave të tjera të administruara gjatë procedurës, gjyqtarja në masë të mjaftuar vërtetoi se i pandehuri, ka bërë kundërvajtje ashtu si e rëndon kjo kërkesë, andaj për këtë është shpallur fajtor dhe është denuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi, kurse mbrojtjen e të pandehurit e hudhi si të pa bazë.

Me rastin e shqiptimit të denimit Gjyqtarja vlerësoi të gjitha rrethanat konform nenit 7 të LMK andaj të LMK-ës të pandehurit i shqiptoi gjobën e zbutur, duke llogaritur se edhe me këtë llojë të denimit te i pandehuri mund të arrihet efekti i sanksionimit që i pandehuri në të ardhmën mos të kryej kundërvajtje të këtilla dhe të ngjajshme.

Me sa u cekë më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

UVENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË

GJYQTARJA

Lindita Jakupi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Lartë për kundërvajtje në Prishtinë, brenda 8 ditësh pas marrjes së të njejtit dhe pa taksa.